

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Primitje: 17.01.2023		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-052/01-3176		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, me 17.01.2023

PËR:	z.Daut Azemi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Lipjan
Nga	Majlinda Sylejmani, Kryesuese e Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit
LËNDA :	Raporti i Punës së Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

I nderuar Kryesues, përmes kësaj shkrese po ju dorëzojme Raportin e Punës së Komisionit për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit, dhe kërkojmë nga ana e juaj që të njejtin ta procedoni si pike të rendit të ditës për mbledhjen e ardhëshme të Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Ju faleminderit!



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

RAPORT I PUNËS

Komisioni për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

Lipjan, Janar 2023

Në bazë të nenit 10 pika 3 dhe 4 të Rregullores për bashkëpunim e Komunës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane nr.15-020-63687 të datës 24.09.2019, Komisioni për organizimin e zgjedhjeve i prezanton Kuvendit të Komunës këtë raport pune:

Sqarim: Ky raport i punës përmbanë dy raporte të pjesërishme nga dy komisione me përbërje të ndryshëm antarësh, kjo për shkak të pezullimit të punës si komision nga gjendja me pandeminë Globale Covid-19 dhe pastaj shkak i ndërrimit të legjislaturës së Kuvendit Komunal, pas Zgjedhjeve Lokale 2021.

RAPORT

Tetor - Mars 2020

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 par.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 për organizimin ,funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ,nenit 9 të Rregullores për organizim, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me ,vendbanimet dhe lagjet urbane Nr.15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2019 pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoj këtë:

Vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale me këtë përbërje, si vijon:

- 1.Hyra Bytyçi, nga subjekti politik LDK, Kryesuese**
- 2. Lumturije Bytyqi-Hasani, nga subjekti politik PDK, anëtare**
- 3. Shkezen Bislimi, nga subjekti politik PDK, anëtare**
- 4. Ganimete Qeriqi, nga subjekti politik AAK, anëtare**
- 5. Avni Olluri, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar**
- 6. Denis Gashi nga shoqëria civile, anëtar**
- 7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokalitetet ku bëhet zgjedhja**

e këshillit lokal, anëtar.

Komisioni menjëherë pas konstituimit me datë: 03.02.2020 mbajti mbledhjen e parë për

hartimin e agjendës së tubimeve zgjedhore, duke u bazuar në Statutin e Komunës së Lipjanit dhe në Rregulloren për Organizim dhe Koordinim të këshillave lokale dhe lagjeve urbane. Në orar u përfshin gjithsej 52 vendbanime duke përfshirë këtu edhe 3 lagje urbane të qytetit të Lipjanit.

Për shkak të nevojës për staf mbështetës komisioni përmes kërkesës të datës 28.02.2020 ka kërkuar edhe një anëtar shtesë. Kemi marrë përgjigje nga shkresa 1-016-12487, se Komuna ka ofruar një zyrtar për logjistikë nga administrata Komunale. Zyrtari Komunal, Diamant Bytyqi i cili është bërë pjesë e komisionit dhe do të kompensohet me mëditje sikur komisioni. Komisioni caktojë periudhën kohore të mbajtjes së tubimeve zgjedhore nga data: 02.03.2020 deri me 30.03.2020, gjithsej nga dy tubime çdo ditë të javës ,përfshirë orarin e festave, duke filluar nga ora 17:00 me tubimin e pare zgjedhor në një vendbanim, pastaj nga ora 19:00 me tubimin e dytë, duke shfrytëzuar edhe hapësirën e nevojshme kohore, nga një tubim tek tubimi tjetër.

Orari ishte shpërndarë me kohë edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në mjetet tjera informuese elektronike.

Komisioni filloi mbajtjen e tubimeve sipas orarit të paraparë me datë: 02.03.2020, gjatë mbajtjes së tubimeve komisioni zgjodhi kryetarët dhe këshillat lokale në gjithsej: 18 vendbanime të komunës së Lipjanit. Procesi zgjedhor ka qenë transparent, nuk ka pasur ndonjë parregullsi. Qytetarët kanë pasur mundësin: të zgjedhin kryetarët dhe anëtarët e këshillave lokale sipas vullnetit të tyre.

Vendbanimet ku u zgjodhën kryetarët dhe këshillat lokale janë: Akllap, Janjevë, Baicë, Krojmir, Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Qylagë, Vërshëc, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Smallushë, Slllovi/Tërbuc, Poturoc, Torinë, Rufc i Vjetër, Ribarë i Vogël, Leletiq dhe Mirenë.

Mirëpo, për shkak të gjendjes me Pandeminë Globale COVID-19, komisioni ndërpres aktivitetet përkohësisht me datë: 11.03.2020, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të publikuara me datë: 11.03.2020, duke u bazuar në masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së korona virusit si dhe rekomandimeve të dala nga IKSHP-ja.

Komisioni me datë: 12.03.2020 nxori vendimin për pezullimin e përkohshëm për të gjitha aktivitetet për mbajtjen e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave dhe lagjeve urbane, deri në një vendim tjetër të Qeverisë. Komisioni prapë do të vazhdoj me mbajtjen e tubimeve zgjedhore në komunën e Lipjanit deri në një datë tjetër.





Andaj duke marrë parasysh që gjendja pandemike po vazhdon dhe ende janë në fuqi vendimet për pezullim të aktiviteteve, dhe në anën tjetër po mbyllet viti fiskal 2020, kërkojmë nga Komuna që të kompensojë anëtarët e Komisionit për Organizim dhe Koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave lokale, më mëditje për tubimet që kanë përfunduar gjatë vitit 2020.

Më poshtë po japim edhe statistikat e zgjedhjeve të mbajtura gjatë kësaj periudhe:

Nga 52 tubime zgjedhore të parapara për shkak të situates pandemike janë mbajtur 18 prej tyre.

- Janë zgjedhur 18 Këshilla të fshatrave.
- Janë zgjedhur 18 Kryetar të Këshillave të fshatrave.

Gjithsejt anëtarët e zgjedhur të Këshillave	156
Meshkuj	152
Femra	4
Serb	
Ashkali	2
Rom	1
Turk	1
Kroat	1

1. Hyra Bytyçi, Kryesues i Komisionit 
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare 
3. Shkelzen Bislimi, anëtar 
4. Ganimete Qeriqi anëtar 
5. Deniz Gashi, anëtar 
6. Avni Olluri, anëtar 
7. Diamant Bytyqi, anëtar shtesë 
7. , anëtar 

RAPORT

Qershor - Dhjetor 2022

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 për organizimin ,feksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ,nenit 9 të Rregullores për organizim, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr.15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 31.03.2022 pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoj këtë:

Vendim për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale me këtë përbërje si vijon:

- 1. Majlinda Sylejmani, anëtare e Kuvendit nga subjekti politik LDK - Kryesuese**
- 2. Rinor Murati, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik LDK - anëtar**
- 3. Lulzim Rrustemi, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik PDK - anëtar**
- 4. Fadil Spahiu, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik LVV - anëtar**
- 5. Hyra Bytyqi Shabani, nga ekzekutivi i Komunës - anëtare**
- 6. Majlinda Krasniqi nga shoqeria civile - anëtare**
- 7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokalitetet ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar.**

Komisioni menjëherë pas konstituimit me datë: 26.05.2022 mbajti mbledhjen e parë për hartimin e agjendës së tubimeve zgjedhore, duke u bazuar në Statutin e Komunës së Lipjanit dhe në Rregulloren për Organizim dhe Koordinim të këshillave lokale dhe lagjeve urbane. Në orarë u përfshinë gjithsej 41 vendbanime duke përfshirë këtu edhe 2 vendbanime (Baicë dhe Krojmir) në të cilat paraprakisht Kryetarët e zgjedhur nga komisioni i parë, kanë dhënë dorëheqje.

Në orar u përfshinë edhe 5 lagje urbane të qytetit të Lipjanit.

Komisioni caktoi periudhën kohore të mbajtjes së tubimeve zgjedhore nga data: 15.06.2022 deri me 06.07.2022.

Orari ishte shpërndarë me kohë në webfaqen zyrtare të Komunës si dhe në mjetet tjera informuese elektronike.

Komisioni filloj mbajtjen e tubimeve sipas orarit të paraparë me datë: 15.06.2022, gjatë mbajtjes së tubimeve komisioni zgjodhi kryetarët dhe këshillat lokal në gjithsej 11 vendbanime dhe 5 të tjera në të cilat procesi ka dështuar me mospjesëmarrje të qytetarëve. Procesi zgjedhor në 11 vendbanimet e mbajtura ka qenë transparent dhe nuk ka pasur ndonjë parregullësi. Qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin kryetarët dhe antarët e këshillave lokale sipas vullnetit të tyre.

Vendbanimet ku u zgjodhën kryetarët dhe këshillat lokale janë: Baicë, Kraishtë, Ribar i Madh, Kojskë, Medvec, Magure, Banullë, Gllogovc, Grackë e Vogël, Zllakuqan dhe Vrellë e Magures.

Ndërsa vendbanimet në të cilat procesi zgjedhor ka dështuar për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve janë: Rufc i Ri, Rubovc i Madh, Dobrajë e Vogël, Dobrajë e Madhe dhe Topliqan.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 22.06.2022, Komisioni për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit, duke marrë për bazë numrin e vendbanimeve në të cilat procesi zgjedhor ka dështuar me mospjesëmarrje të qytetarëve për shkaqe të ndryshme, si: pushimet verore, angazhimet në punët blegtorale dhe bujqësore si dhe duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve komisioni vendosi në pezullimin e përkohëshëm të këtij procesi deri në një kohë më të përshtatshme për mbajtjen e këtyre takimeve.

Komisioni për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me datë 03.11.2022 vendosi për vazhdimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.

Komisioni caktoi periudhën kohore të mbajtjes së tubimeve zgjedhore nga data: 19.11.2022 deri me datë 04.12.2022.

Orari ishte shpërndarë me kohë në webfaqen zyrtare të Komunës, në tabelën e shpalljeve si dhe në mjetet tjera informuese elektronike.

Komisioni filloj mbajtjen e tubimeve sipas orarit të paraparë me datë: 19.11.2022, gjatë mbajtjes së tubimeve komisioni zgjodhi kryetarët dhe këshillat lokal në gjithsej 29 vendbanime dhe 1 vendbanim (Rubovc i Madh) në të cilin procesi zgjedhor ka dështuar.

Nga këto vendbanime, në vendbanimet: Konjuh, Grackë e Vjetër dhe Jeta e Re, procesi zgjedhor përfundoi me sukses në takimin e dytë, ndërsa në Topliqan, procesi zgjedhor përfundoi me sukses

në takimin e tretë, pasi që në takimet e mëparshme nuk kishte pjesëmarrje të mjaftueshme të qytetarëve.

Ndërsa në vendbanimin Rubovc i Madh duke u bazuar në mundësitë që Komisioni u ka ofruar qytetarëve të këtij vendbanimi për tu organizuar, tre herë radhazi por pa sukses, ky proces zgjedhor përfundoj pa këshill të fshatit në këtë vendbanim.

Gjatë gjithë kësaj periudhe si Komision kemi pranuar vetëm një ankesë nga disa banorë të fshatit Bujan, të cilëve iu jemi përgjigjur si komision në koordinim me zyrën ligjore të Komunës.

Më poshtë po japim edhe statistikat e zgjedhjeve të mbajtura gjatë kësaj periudhe:

Nga 41 tubime zgjedhore të parapara janë mbajtur 40 prej tyre.

- Janë zgjedhur 40 Këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane.
- Janë zgjedhur 40 Kryetar të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.

- Numri i pjesëmarrësve: 1345
- Femra : 74
- Meshkuj : 1271

Gjithsejt anëtarët e zgjedhur të Këshillave	326
Meshkuj	305
Femra	21
Serb	5
Ashkali	4
Rom	0
Turk	0
Kroat	0

Statistikat e përgjithshme nga të dy komisionet për organizimin dhe koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

- Janë zgjedhur 56 Këshilla të fshatrave dhe lagjeve urbane.
- Janë zgjedhur 56 Kryetar të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Gjithsejt anëtarët e zgjedhur të Këshillave	482
Meshkuj	457
Femra	25
Serb	5
Ashkali	7
Rom	0
Turk	0
Kroat	1


Bashkë me këtë raport pune ju bashkangjesim edhe listën e Kryetarëve të zgjedhur të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit

NR.	VENDBANMI	EMRI DHE MBIEMRI
1	Akllap	Muharrem Gashi
2	Babush i Muhaxherëve	Idriz Sopà
3	Baincë	Sheremet Kolshi
4	Banullë	Afrim Hajrullahu
5	Bregu i Zi	Mehdi Avdyli
6	Brus	Engjëll Gashi
7	Bujan	Lirim Dragaqina
8	Dobrajë e Madhe	Skender Gashi
9	Dobrajë e Vogël	Besnik Jashari
10	Gadime e Epërme	Mustafë Rexhepi
11	Gadime e Ulët	Kujtim Aliu
12	Gllanicë	Bleart Pllana
13	Gllavicë	Naim Reçica
14	Glllogovc	Bardhyl Ibrahimì
15	Grackë e Vjetër	Milaim Xhema
16	Grackë e Vogël	Ali Sopà
17	Gumansellë	Besim Seferi
18	Hallaq i Madh	Agron Zeqiri
19	Hallaq i Vogël	Ahmet Zeqiri
20	Janjevë	Behxhet Konxheli
21	Jeta e Re	Behar Krasniqi
22	Kleçkë	Milazim Shala
23	Kojskë	Armend Maxheri
24	Konjuh	Gazmend Sylejmani
25	Kraishtë	Imri Lacaj
26	Krojmìr	Sinan Qeriqi
27	Lagja e Akllapit, Lipjan	Zymer Ahmeti
28	Lagja Qendër, Lipjan	Gëzim Bytyqi
29	Lagja te Kisha, Lipjan	Jovica Miric
30	Lagja te Xhamia, Lipjan	Kamer Podrimqaku

31	Leletiq	Muharrem Latifi
32	Lluga	Nazmi Krasniqi
33	Llugaxhi	Ali Tmava
34	Magure	Ramiz Gashi
35	Marevc	Valon Marevci
36	Medvec	Besim Ramadani
37	Mirenë	Qerim Fazliu
38	Poturovc	Smajl Shabani
39	Qellopek	Ilaz Bedrolli
40	Qylagë	Gezim Bytyqi
41	Resinove	Gentrit Sinani
42	Ribar i Madh	Sylejman Bllaca
43	Ribar i Vogël	Nysret Kelmendi
44	Rubove i Vogël	Rinor Reçica
45	Rufc i Ri	Agron Gorani
46	Rufc i Vjetër	Ismet Ahmeti
47	Shalë	Xhyla Korpuzi
48	Sillovi /Tërbuc	Murat Gerbeshi
49	Smallushë	Izjadin Krasniqi
50	Teqe	Xhelal Krasniqi
51	Topliqan	Njazi Sllamniku
52	Torinë	Abedin Ilazi
53	Vërshevc	Naser Duh laku
54	Vrellë e Gadimes	Asllan Thaqi
55	Vrellë e Goleshit	Haki Shala
56	Zllakuqan	Valmir Krasniqi

Lipjan, Janar 2023

1. Majlinda Sylejmani, Kryesuese e Komisionit




2. Rinor Murati, anëtar



3. Lulzim Rrustemi, anëtar



4. Fadil Spahiu, anëtar



5. Hyra Bytyqi Shabani, anëtare



6. Majlinda Krasniqi, anëtare

